



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Kodi i lëndës: INF 340
Lënda: Urgjencë Mjekësore

PROGRAMI I LËNDËS Urgjencë Mjekësore									
Titullari i lëndës:		Fatjona Kamberi <i>PhD në Shkenca Infermierore</i> _____							
Ngarkesa:	Kredite	Orë mësimi në auditor						Studim individual	Totali
	6 ECTS	Leksion	Seminar	Ushtr	Praktikë	Projekt	Total	75	150
Tipologjia e lëndës		Lëndë ndërdisiplinore / integruese							
Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda		Viti III, Semestri I							
Lloji i lëndës		Me zgjedhje							
Programi i studimit		Bachelor në "Infermieri të Përgjithshme"							
Kodi i lëndës		INF 340							
Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës		fatjona.kamberi@univlora.edu.al							

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	
Përshkrimi i lëndës	Në këtë lëndë studentët do të marrin njohuritë bazë dhe teknikat praktike për vlerësimin dhe menaxhimin e gjendjeve shëndetësore kërcënuese për jetën dhe të personave të dëmtuar. Realizimi i praktikave mësimore në spital ka në fokus përvetësimin e shpejtë dhe të saktë të kujdesit infermieror të urgjencës në përputhje me prioritetet.
Objektivat e lëndës	<ul style="list-style-type: none">▪ Përfitimi i njohurive bazë në lidhje me urgjencën mjekësore dhe triazhimin.▪ Të kuptuarit e rëndësisë së vlerësimit në kohë të pacientit dhe aftësimi për të njohur dhe praktikuar ndihmën jetësore bazë dhe të avancuar.▪ Aftësimi për të njohur dhe menaxhuar urgjencat kardiovaskulare, pulmonare, abdominale, urinare dhe mjedisore.▪ Aftësimi për të njohur urgjencat nga intoksikacionet e ndryshme dhe indikacionet specifike të menaxhimit të tyre.
Rezultatet e pritshme	Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje: ☞ Përshkruajnë dhe analizojnë urgjencat më të shpeshta në praktikën infermierore të urgjencës. ☞ Implementojnë vlerësimin e pacientit në bazë të problematikës që paraqet. ☞ Analizojnë urgjencat infermierore dhe prioritetet e pacientit. ☞ Përshkruajnë ndërhyrjet terapeutike më të përshtatshme për një urgjencë të caktuar mjekësore. ☞ Përfitojnë aftësi praktike në menaxhimin e saktë dhe cilësor të kujdesit infermieror të urgjencës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

KONCEPTET THEMELORE

1. Ndhima jetësore bazë dhe e avancuar.
2. Triazhimi dhe kodet e triazhimit.
3. Urgjencat mjekësore sipas sistemeve të organizmit dhe menaxhimi infermieror i tyre.
4. Urgjencat mjedisore dhe menaxhimi infermieror i tyre.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	Tema 1 – Hyrje në Urgjencën Mjekësore, Infermirore. Çështje bazë të urgjencës infermirore; Aspekte ligjore, etike dhe kulturore. Urgjencia dhe vlerësimi infermieror. <i>Organizimi dhe fokusi i studimit të lëndës. Njohja me literaturën bazë dhe urgjencat që do trajtohen në modul. Aspekte ligjore, etike dhe kulturore që duhet të kihen parasysh nga infermierët për menaxhimin e duhur të urgjencave mjekësore.</i> Tema 2 – Triazhimi (sistemet e triazhimit, kodi i prioritetit, vlerësimi i triazhimit, ritriazhimi, gabimet e triazhimit). <i>Njohja me konceptin/ procesin e triazhimit dhe roli i infermierit. Sistemet e ndryshme të triazhimit, vlerësimi infermieror dhe kodi i prioritetit.</i> Tema 3 –Triazhimi (tabela e klasifikimit të urgjencave mjekësore). <i>Njohja dhe përshkrimi i tabelës së klasifikimit të urgjencave të përdorur në vendin tonë.</i>	⁽¹⁾ fq.6-13	Leksion 1 orë
	Praktikë mësimore në repartin e Urgjencës Mjekësore.	⁽¹⁾ fq.14-24	Leksion 1 orë
	Praktikë mësimore në repartin e Urgjencës Mjekësore.	⁽¹⁾ fq.25-30	Leksion 1 orë
II.	Tema 4 – Arresti kardiak. Reanimimi kardio-respirator. Rrugët e ajrit. Urgjencia të rrugëve të ajrit. <i>Njohja me shenjat karakteristike të arrestit kardiak. Ndhima jetësore bazë/e avancuar dhe zinxhiri i mbijetesës.Teknika e reanimimit kardio-respirator.Njohja dhe menaxhimi i urgjencave të rrugëve të ajrit.</i> Tema 5 –Aritmitë Kardiake. <i>Njohja dhe menaxhimi i aritmive kardiake specifike të urgjencës mjekësore.</i> Tema 6 –Infarkti i miokardit. <i>Vlerësimi i dhimbjes së gjoksit, sindromi koronar akut, planifikimi dhe implementimi i ndërhyrjeve infermirore.Algoritmi i trajtimit.</i>	⁽¹⁾ fq.31-44	Leksion 1 orë
	Praktikë mësimore në repartin e Urgjencës Mjekësore.	⁽¹⁾ fq.45-50	Leksion 1 orë
	Praktikë mësimore në repartin e Urgjencës Mjekësore.	⁽¹⁾ fq.51-58	Leksion 1 orë
III.	Tema 7 –Angina pectoris stabile. <i>Njohja dhe vlerësimi i angina pectoris stabile.Planifikimi dhe implementimi i ndërhyrjeve infermirore të urgjencës.</i> Tema 8 –Urgjencia Hipertensive. Sinkopi. Hipotensioni. <i>Përkufizimi i urgjencës hipertensive, sinkopit dhe hipotensionit.Menaxhimi i tyre në repartin e urgjencës mjekësore.</i> Tema 9 –Edema pulmonare. <i>Njohja me shenjat dhe simptomat e edemës pulmonare.Trajtimi i edemës pulmonare kardiogjene, jokardiogjene dhe nga lartësitë e mëdha.</i>	⁽¹⁾ fq.59-61	Leksion 1 orë
	Praktikë mësimore në repartin e Urgjencës Mjekësore.	⁽¹⁾ fq.62-71	Leksion 1 orë
	Praktikë mësimore në repartin e Urgjencës Mjekësore.	⁽¹⁾ fq.72-74	Leksion 1 orë
IV.	Tema 10 – Embolia pulmonare. <i>Njohja me shenjat dhe simptomat e embolisë pulmonare.Ndërhyrjet terapeutike</i>	⁽¹⁾ fq.75-76	Leksion 1 orë



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p>të urgjencës.</p> <p>Tema 11 –Shoku hipovolemik. Shoku kardiogjen. <i>Përkufizimi dhe klasifikimi i shokut hipovolemik. Njohja me shenjat dhe simptomat si dhe ndërhyrjet terapeutike. Shoku kardiogjen, shenjat dhe simptomat si dhe ndërhyrjet terapeutike të urgjencës.</i></p> <p>Tema 12 –Shoku distributiv (anafilaktik, neurogjen, septik). Shoku obstruktiv. <i>Njohja me shenjat dhe simptomat e tri kategorive të shokut distributiv.Ndërhyrjet terapeutike për menaxhimin urgjent të tyre. Përkufizimi i shokut obstruktiv dhe ndërhyrjet terapeutike.</i></p> <p>Praktikë mësimore në repartin e Urgjencës Mjekësore.</p>	<p>⁽¹⁾fq.77-83</p> <p>⁽¹⁾fq.84-88</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
V.	<p>Tema 13 – Astma e rënde akute dhe menaxhimi i saj. SPOK, acarimi akut. <i>Njohja me shenjat dhe simptomat e astmës së rëndë akute dhe SPOK.Roli i egzaminimit fizik dhe ndërhyrjet terapeutike.</i></p> <p>Tema 14 –Pneumotoraksi ; Sindromi i detresit respirator akut. <i>Llojet e pneumotoraksit, shenjat dhe simptomat e pneumotoraksit dhe sindromit të detresit respirator akut,ndërhyrjet terapeutike.</i></p> <p>Tema 15 –Hemoptizia <i>Menaxhimi i hemoptizisë masive dhe minore.</i></p> <p>Praktikë mësimore në repartin e Urgjencës Mjekësore.</p>	<p>⁽¹⁾fq.89-93</p> <p>⁽¹⁾fq.94-96</p> <p>⁽¹⁾fq.97-100</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
VI.	<p>Tema 16 – Epistaksis. <i>Njohja me shenjat dhe simptomat e epistaksis, vlerësimi dhe ndërhyrjet terapeutike të urgjencës.</i></p> <p>Tema 17 –Urgjencat abdominale. Abdomeni akut. <i>Njohja me shkaqet më të zakonshme të dhimbjes abdominale dhe strategji të përgjithshme për menaxhimin infermieror të abdomenit akut në urgjencë.</i></p> <p>Tema 18 –Diarrea e rëndë akute. <i>Vlerësimi, planifikimi dhe implementimi i ndërhyrjeve infermierore të urgjencës, monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve.</i></p> <p>Praktikë mësimore në repartin e Urgjencës Mjekësore.</p>	<p>⁽¹⁾fq.101-103</p> <p>⁽¹⁾fq.104-109</p> <p>⁽¹⁾fq.110-111</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
VII.	<p>Tema 19 – Hematemeza, melena, rektoragjia. <i>Përkufizimi dhe ndërhyrjet terapeutike për hematemezën, melenën dhe rektoragjinë.</i></p> <p>Tema 20 –Çrregullimet e kolecistës dhe pankreatiti akut. <i>Vlerësimi, planifikimi dhe implementimi i ndërhyrjeve infermierore të urgjencës.Administrimi i terapisë farmakologjike të përshkruar.</i></p> <p>Tema 21 –Ileusi – okluzioni intestinal. <i>Vlerësimi, planifikimi dhe implementimi i ndërhyrjeve infermierore të urgjencës.</i></p> <p>Praktikë mësimore në repartin e Urgjencës Mjekësore.</p>	<p>⁽¹⁾fq.112-115</p> <p>⁽¹⁾fq.116-120</p> <p>⁽¹⁾fq.121-122</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
VIII.	<p>Tema 22 – Apendicitis akut. <i>Vlerësimi, planifikimi dhe implementimi i ndërhyrjeve infermierore të urgjencës.</i></p> <p>Tema 23 –Intoksikacioni nga acidet, bazat dhe insekticidet.</p>	<p>⁽¹⁾fq.123-124</p> <p>⁽¹⁾fq.125-128</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>Njohja me kategoritë e ndryshme të acideve dhe bazave, shenjat dhe simptomat si dhe dhënia e ndihmës së parë sipas rrugës së marrjes së substancave kimike. Shenjat dhe simptomat e intoksikacionit nga insekticidet dhe ndërhyrjet terapeutike urgjente.</i></p> <p>Tema 24 – Intoksikacioni nga drogat , medikamente. <i>Njohja e shenjave dhe simptomave në intoksikacione nga droga dhe medikamente të ndryshme. Vlerësimi, planifikimi dhe implementimi i ndërhyrjeve infermiere..</i></p> <p>Praktikë mësimore në repartin e Urgjencës Mjekësore.</p>	<p>⁽¹⁾fq.129-136</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
IX.	<p>Tema 25 – Intoksikacioni nga alkooli. <i>Njohja me fazat e intoksikacionit nga alkooli, vlerësimi i gjendjes, planifikimi dhe implementimi i ndërhyrjeve infermiere.</i></p> <p>Tema 26 – Kafshimet dhe pickimet helmuese. <i>Kujdesi dhe qendrimi që duhet të mbaj një infermier në rastin kur paraqiten persona të kafshuar, ndihma e parë, shenjat dhe simptomat karakteristike për kafshime dhe pickime nga kafshë të caktura. Planifikimi dhe ndërhyrjet terapeutike infermiere.</i></p> <p>Tema 27 – Trupat e huaj në hundë, gojë, veshë, sy, lëkurë. <i>Njohja dhe dallimi i shenjave dhe simptomave të trupave të huaj në hundë, gojë, veshë, sy, lëkurë, vlerësimi dhe ndërhyrjet terapeutike.</i></p> <p>Praktikë mësimore në repartin e Urgjencës Mjekësore.</p>	<p>⁽¹⁾fq.137-139</p> <p>⁽¹⁾fq.140-143</p> <p>⁽¹⁾fq.144-148</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
X.	<p>Tema 28 – Temperaturat e larta – goditja nga dielli. <i>Vlerësimi i gjendjes, shenjat dhe simptomat e goditjes nga dielli, planifikimi dhe implementimi i ndërhyrjeve infermiere.</i></p> <p>Tema 29 – Djegiet. <i>Ndihma e parë sipas llojit të djegies, vlerësimi dhe trajtimi në urgjencë i pacientit të djegur.</i></p> <p>Tema 30 – Goditja nga rryma elektrike. <i>Ndihma e parë, vlerësimi, planifikimi dhe implementimi i ndërhyrjeve infermiere.</i></p> <p>Praktikë mësimore në repartin e Urgjencës Mjekësore.</p>	<p>⁽¹⁾fq.149-152</p> <p>⁽¹⁾fq.153-160</p> <p>⁽¹⁾fq.161-163</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
XI.	<p>Tema 31 – Hipotermia <i>Njohja e shenjave dhe simptomave sipas gradave të ndryshme të hipotermisë, vlerësimi, planifikimi dhe implementimi i ndërhyrjeve infermiere.</i></p> <p>Tema 32 – Ngrirja <i>Njohja e shenjave dhe simptomave sipas gradave të ndryshme të ngrirjes, vlerësimi, planifikimi dhe implementimi i ndërhyrjeve infermiere.</i></p> <p>Tema 33 – Tetanozi. <i>Vlerësimi i shenjave dhe simptomave të tetanozit. Ndërhyrjet terapeutike në urgjencë.</i></p> <p>Praktikë mësimore në repartin e Urgjencës Mjekësore.</p>	<p>⁽¹⁾fq.164-166</p> <p>⁽¹⁾fq.167-169</p> <p>⁽¹⁾fq.170-171</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
XII.	<p>Tema 34 – Gangrena gazoze. <i>Vlerësimi i shenjave dhe simptomave të gangrenës gazoze. Ndërhyrjet terapeutike në urgjencë.</i></p>	<p>⁽¹⁾fq.172-173</p>	<p>Leksion 1 orë</p>



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p>Tema 35 –Konvulsionet – epilepsia. <i>Njohja e gjendjes së epilepsisë dhe menaxhimi infermieror në urgjencë.</i></p> <p>Tema 36 –Konvulsionet (metabolike, hiperpiretike). <i>Njohja me shenjat dhe simptomat e konvulsioneve metabolike dhe hiperpiretike.Ndërhyrjet terapeutike.</i></p> <p>Praktikë mësimore në repartin e Urgjencës Mjekësore.</p>	<p>⁽¹⁾fq.174-176</p> <p>⁽¹⁾fq.177-188</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
XIII.	<p>Tema 37 – Aksidentet vaskulare cerebrale iskemike. <i>Shenjat dhe simptomat, vlerësimi i gjendjes. Shkalla prespitorale CINCINNATI, komponentët për vlerësimin e ashpërsisë së aksidentit vaskular cerebral dhe ndërhyrjet terapeutike.</i></p> <p>Tema 38 –Aksidentet vaskulare cerebrale hemoragjike. <i>Shenjat dhe simptomat, vlerësimi i gjendjes dhe ndërhyrjet terapeutike.</i></p> <p>Tema 39 –Koma (hiperglicemike, hypoglicemike, hepatike). Ketoacidoza diabetike. <i>Egzaminimi fizik i përgjithshëm, shenjat dhe simptomat në komat e tipeve të ndryshme dhe terapia emergjente në pacientët me këto koma.</i></p> <p>Praktikë mësimore në repartin e Urgjencës Mjekësore.</p>	<p>⁽¹⁾fq.182-185</p> <p>⁽¹⁾fq.186-187</p> <p>⁽¹⁾fq.188-193</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
XIV.	<p>Tema 40 – Koma (metabolike, toksike). <i>Egzaminimi fizik i përgjithshëm, shenjat dhe simptomat në komat e tipeve të ndryshme dhe terapia emergjente në pacientët me këto koma.</i></p> <p>Tema 41 –Kolikat renale <i>Shenjat dhe simptomat,ndërhyrjet terapeutike të urgjencës.</i></p> <p>Tema 42 –Politraumat. Vlerësimi dhe stabilizimi i pacientit. <i>Njohja me sistemin e traumës.Sjellja ndaj një pacienti me trauma.Vlerësimi dhe ndërhyrjet terapeutike.</i></p> <p>Praktikë mësimore në repartin e Urgjencës Mjekësore.</p>	<p>⁽¹⁾fq.188-193</p> <p>⁽¹⁾fq.194-195</p> <p>⁽¹⁾fq.196-199</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
XV.	<p>Tema 43 – Politraumat. Trauma specifike. <i>Shenjat dhe simptomat të traumave specifike (tamponada kardiake,traumat e mbyllura abdominale, traumat penetruese abdominale).Ndërhyrjet terapeutike dhe menaxhimi i traumës në urgjencë.</i></p> <p>Tema 44–Urgjencat psikiatrike. <i>Triazhimi i shëndetit mendor, vlerësimi, urgjencat më të zakonshme të shëndetit mendor dhe menaxhimi i tyre.</i></p> <p>Tema 45 –Trajtimi i pacientëve të dhunuar në repartin e urgjencës. <i>Njohja dhe menaxhimi i llojeve të ndryshme të dhunës që paraqiten në urgjencë.</i></p> <p>Praktikë mësimore në repartin e Urgjencës Mjekësore.</p>	<p>⁽¹⁾fq.200-206</p> <p>⁽¹⁾fq.207-210</p> <p>⁽¹⁾fq.211-216</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI:	<p>Kyçi i një edukimi të suksesshëm është pjesëmarrja dhe përgatitja. Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së</p>
---------------------	---



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	infirmierit). Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studenti humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.					
KONTROLLI I VAZHUESHËM	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
	Provimi I	Java 7/8	15 leksione	30 pikë	Provim me shkrim	Pyetje me shtjellim, pyetje quiz, situata për menaxhim
	Provimi përfundimtar	Fundi i semestrit	30 leksione	60 pikë	Provim me shkrim	Pyetje me shtjellim, pyetje quiz, situata për menaxhim
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Java 14/15	Raste klinike	10 pikë	Prezantim me gojë	Përshkrimi i rasteve klinike të hasura gjatë praktikës në repartin e Urgjencës Mjekësore
	*Vlerësim i vazhduar -Do të jetë në formën e një projekti që do të filloj në fillim të semestrit. Studentët do të përshkruajnë raste klinike të hasura në repartin e Urgjencës Mjekësore gjatë kryerjes së praktikës mësimore si dhe krahasimi në aspektin e menaxhimit infermieror të urgjencave të hasura në praktikë me urgjencat që janë trajtuar në teori. Është parashikuar prezantimi i rasteve klinike në formatin ppt.					
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare do të jetë si më poshtë:					
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë
5	6	7	8	9	10	

LITERATURA	
Literatura bazë e detyruar	(1) Urgjenca Infermirore Cikël Leksionesh Fatjona Kamberi, Juljana Xhindoli... Edicioni i parë. Shtypur në Tiranë: Gent Grafik, 2017. ISBN: 978-9928-202-50-5.
Literatura e rekomanduar	<ul style="list-style-type: none"> ○ ‘Sheehy’s Manual of Emergency Care’ (2013). Emergency Nurses Association (ENA) - 7 th edition/ edited by Belinda B Hammond, Polly Zimmermann. ISBN-13: 978-0-323-07827-6. ○ Clinical Emergency Medicine’, McGraw-Hill. (2014). ISBN: 978-0-07-179460-2. ○ Emergency & Critical Care Pocket Guide ACLS Version, Eighth Edition (2014). Jones & Bartlett Learning, LLC, an Ascend Learning Company. ISBN: 978-1-284-02370- ○ Emergency Nursing Core Curriculum (2007), by Saunders, an imprint of Elsevier Inc. ISBN: 978-1-4160-3755-2. ○ ‘Urgjencat Mjekësore’(2013). Diana Kozdine. FSHP-UV



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

Dispozita:	<p>Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregojnë interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto prirshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjatë procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.</p>
Vonesat	<p>Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.</p>
Sjellja profesionale e studentit	<p>Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digjitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimi, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimi, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijancë nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.</p>
Integriteti akademik dhe e drejta e autorit	<p>Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale, dhe në pamundësi të referojnë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzierjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.</p>
Karakteristikat e detyrave të kursit	<p><i>Rregullat për paraqitjen e detyrave / projekteve të kursit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">▪ Të gjitha punimet duhet të dorëzohen në kohën e caktuar. Ato duhet të tregojnë që në paraqitje një stil profesionist.▪ Duhet të jenë të shtypura. Punet me shkrim dore nuk do të pranohen dhe studenti do të vlerësohet automatikisht me 0 pikë.▪ Në punime gjuha duhet të jetë zyrtare, letrare dhe neutrale. Ndalohet rreptësisht përdorimet e zhargoneve të pa argumentuara, shprehjet që rëndojnë etikën profesionale dhe njerëzore, kërcënimet, fyerjet, sharjet, etiketimet, tendencat politizuese, trajtimet jashtë tematikave të kërkuara, etj.▪ Punët duhet të kenë një volum me më tepër se 3 faqe (format A⁴, shkrimi Times New Roman, 12 pt) dhe në faqet e para duhet të jenë të shënuara pa gabime drejtshkrimore: <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; margin-top: 10px;"><p>Emri i Studentit Titulli i punimit Kursi dhe grupi përkatës i studentit Data e dorëzimit të punimit sipas grafikut të shpallur Emri i instruktorit Numri i faqeve</p></div>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	<p><i>Elementët e vlerësimit të detyrës së kursit do të përfshijnë:</i></p> <p>Thelbësore:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Respektimin e struktures së punimit shkencor▪ Renditjen e argumenteve akademiko-shkencorë▪ Mënyrat specifike të trajtimit të çështjeve në raport me realitetin shqiptar <p>Ndihmëse:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Ideja e zgjedhur▪ Mënyra e organizimit të punimit▪ Logjika e përdorimit të koncepteve▪ Përputhja me objektivat e programit mësimor▪ Argumentet dhe analiza kritike
--	--